

Numri i lëndës: 2022:124109

Datë: 26.01.2024

Numri i dokumentit: 05246649

P.nr. 244/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Dega V., Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, në çështjen penale ndaj të pandehurit Q.L.nga fshati G. Komuna V., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, PP.II.nr.932/2022, e dt. 10.06.2022, PP.II.nr.727/2023, të datës 22.05.2023, PP.II.nr.1101/2023, të datës 07.08.2023, PP.II.nr.1383/2023, të datës 11.09.2023, konform nenit 357 paragrafi 1, nenparagrafi 1.3 të KPPRK-së, jashtë seancës me datë 26.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit Q.L.nga fshati G. Komuna V., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe **HUDHEN** aktakuzat e Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.932/2022, e dt. 10.06.2022, PP.II.nr.727/2023, të datës 22.05.2023, PP.II.nr.1101/2023, të datës 07.08.2023, PP.II.nr.1383/2023, të datës 11.09.2023, për shkak se i pandehuri është i vdekur.

E dëmtuara APK, zyra në V. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i përgjithshëm, ka paraqitur në gjykatën Themelore në Gjilan, Dega në V., aktakuzat PP.II.nr.932/2022, e dt. 10.06.2022, PP.II.nr.727/2023, të datës 22.05.2023, PP.II.nr.1101/2023, të datës 07.08.2023, PP.II.nr.1383/2023, të datës 11.09.2023 ndaj të pandehurit Q.L.nga fshati G. Komuna V., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së.

Komuna e V.së, zyra e regjistrimit civil me parashtresën e datës 20.09.2023 e ka njoftuar gjykatën se personi Q.L.nga fshati G. Komuna V., i lindur me datë 02.08.1997 nuk figuron i regjistruar në gjendjen civile në Komunën e V.së as në LAM, as në LAV.

Nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë sipas kërkesës së gjykatës është dorëzuar çertifikata e vdekjes në fotokopje në emër të Q.L.nga fshati G. Komuna V., i lindur me datë 08.04.2000.

Me parashtresën e datës 11.01.2024 gjykata ka kërkuar nga Stacioni Policor në V. që të verifikohet personi Q.L.nga fshati G. Komuna V., se a ekziston edhe ndonjë person tjetër me këto shënime, pasi që në gjykata ekzistojnë edhe lëndë ndaj Q.L.nga fshati G. Komuna V., mirëpo ditëlindja nuk përputhet me

ditëlindjen e shënuar në certifikatë të vdekjes dhe zyrtarët e Stacionit Policor në V. me datë 26.01.2024 në gjykatë kanë dorëzuar parashtresën, me të cilën e kanë njoftuar gjykatën se Q.L.ka vdekur në aksident trafiku, duke i bashkangjitur edhe certifikatën e vdekjes lëshuar nga IML në Prishtinë. Si dhe në bazë të informatave që kishin me familjarët, nuk ekziston person tjetër me këto të dhëna.

Me aktvendimin P.nr. 244/2022, të datës 26.01.2024 gjykata ka bërë bashkimin e procedurës penale ndaj të pandehurit Q.L.nga fshati G. Komuna V., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.932/2022, e dt. 10.06.2022, PP.II.nr.727/2023, të datës 22.05.2023, PP.II.nr.1101/2023, të datës 07.08.2023, PP.II.nr.1383/2023, të datës 11.09.2023, të evidentuara në gjykatë me numrat P.nr. 244/2022, P.nr. 240/2023, P.nr.338/2023 dhe P.nr.384/2023 dhe kjo lëndë do të evidentohet me numrin unik të lëndës P.n. 244/2022, si lëndë e parë e paraqitur në gjykatë.

Andaj, gjykata në pajtim me nenin 357 paragrafi1, nënparagrafi 1.3 të KPPRK-së si dhe duke marrë parasysh se i pandehuri Q.L.nga fshati G. Komuna V. është i vdekur, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-dega V.
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.244/2022, me datë: 26.01.2024

Gjyqtarja,
Blerina Jakupi Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.